

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
“MOGUL INVEST ” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 10.06.2024 në Tiranë,

Znj.Klesara Fani shtetase shqiptare, e lindur më 23.01.1990 në Shkoder , Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me numër personal : J05123086L.

Znj.Era Xhabafti shtetase shqiptare, e lindur më 07.04.1989 , ne Tirane, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me numër personal : I95407051C.

Z.Egli Haxhiraj, shtetas shqiptar, i lindur më 29.11.1984, ne Vlore, Shqiperi, madhor me zotesi te plote juridike per të vepruar, i identifikuar me numër personal I41129062N.

Z.Arbër Çepani, shtetas shqiptar, i lindur më 08.05.1987, ne Tirane, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me numër personal : I70508090S.

Te cilet kane vendosur themelimin e shoqërisë **Mogul Invest Shpk** , shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria **Mogul Invest Shpk** , është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat .Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2


Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Mogul Invest Shpk**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:



1. Sektori i Pasurive të Paluajtshme:

- Investime në zhvillimin dhe ndërtimin e projekteve të pasurive të paluajtshme rezidenciale, pallate dhe kulla.
- Zhvillimi i resorteve me 5 yje me marka ndërkombëtare dhe kazino.
- Blerje dhe shitje të tokave dhe pasurive të paluajtshme.
- Rinovimi i ndërtesave.

2. Sektori Energjisë:

- Zhvillimi i impianteve fotovoltaike, eolike dhe hidrike.
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e impianteve energjetike.
- Tregtimi i energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme.
- Kërkimi dhe zhvillimi i teknologjive inovative energjetike.
- Realizimi i projekteve të bioenergjisë dhe gjeotermisë.

3. Prokurime Publike dhe Private:

- Pjesëmarrja në tenderë për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave, përfshirë rrugët, sistemet e ndriçimit dhe ujësjellësit.
- Realizimi i punimeve të kantierit.
- Ndërtimi i ndërtesave publike dhe private, përfshirë komplekset industriale dhe komerciale.
- Rinovimi dhe restaurimi i objekteve kulturore dhe historike.
- Menaxhimi dhe koordinimi i projekteve komplekse ndërtimore.
- Realizimi i impianteve teknologjike dhe të sigurisë.

4. Distribuimi i Ushqimeve dhe Pijeve:

- Tregtia me shumicë dhe pakicë e produkteve ushqimore dhe pijeve.
- Marrja e markave ekskluzive ose të përgjithshme për shpërndarjen e këtyre produkteve.
- Menaxhimi i pikave të shitjes me pakicë dhe supermarketeve.
- Importi dhe eksporti i produkteve ushqimore.
- Organizimi i eventeve gastronomike dhe panairove.
- Shërbime katering dhe restoracioni.
- Prodhimi dhe paketimi i produkteve ushqimore.

5. Zhvillimi i Rrjeteve të Franchising:

- Krijimi dhe menaxhimi i rrjeteve ndërkombëtare të franchising në sektorë të ndryshëm.
- Trajnimi dhe asistenca për franchising.

6. Televizioni dhe Media :

- Zhvillimi dhe prodhimi i programeve televizive.
- Menaxhimi dhe shpërndarja e përmbajtjeve multimediale.
- Realizimi i dokumentarëve, serive TV dhe filmave dhe promovimi i tyre
- Krijimi dhe menaxhimi i kanaleve televizive dhe platformave streaming.
- Organizimi i eventeve dhe festivaleve kinematografike.
- Shërbime post-produksioni dhe montazhi video.



NENI 4
Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rr."Sami Frasheri" Pallati Titan Konstruksion,Godina nr.8 , Kati 2, Njesia Administrative Nr.10, zona Ish Ekspozita, Tirane , Shqiperi.

NENI 5
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 4 (kater) kuota. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Znj.Klesara Fani 1 kuotë, me vlerë 25 Lekë, zotëron 25 %

Znj.Era Xhabafti 1 kuotë, me vlerë 25 Lekë, zotëron 25 %

Z.Egli Haxhiraj 1 kuotë, me vlerë 25 Lekë, zotëron 25 %

Z.Arbër Çepani 1 kuotë, me vlerë 25 Lekë, zotëron 25 %

NENI 6
Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.


NENI 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë do të jetë: **Znj.Klesara Fani** shtetase shqiptare, e lindur më 23.01.1990 në Shkoder , Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me numër personal : J05123086L.



Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKET THEMELUES





